



Numri i kontratës:¹: 632-25-3519-5-2-1/C1094

KOMUNA E GJAKOVËS, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njérën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik BEREQETI - ING; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; NNT BINI SH.P.K., Parku i biznesit Drenas, DRENAS, me numër unik 810845638 & 810842668 & 811318999, e përfaqësuar nga Arben Mazreku (ne vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për pune e shënuara me poshtë:

Ndërtimi i parkut dhe lodrave për fëmijë në rrugën Gazmend Ymeri, me numër identifikues: 632-25-3519-5-2-1 dhe numër të brendshëm 632-25-044-521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Ndërtimi i parkut dhe lodrave për fëmijë në rrugën Gazmend Ymeri**

No.	Lot
1	Ndërtimi i parkut dhe lodrave për fëmijë në rrugën Gazmend Ymeri

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **49,811.20 €**(katërdhjetë e nëntëmijë e tetëqind e njëmbëdhjetë euro e njëzetë cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;

Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesin.

Neni 4**Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvèç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" "ose" vendosë "do të interpretohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Faton Gutaj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurorit
Nënshkrimi:	
Data:	03.07.2025
Vula:	

**Për Ofruesin e Shërbimeve**

Emri:	Arben Mazreku
Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:	
Data:	03.07.2025
Vula:	



KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 632-25-3519-5-2-1/C1094

Neni 1 Përkuqizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtuesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupei i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuqtojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruara dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontaktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënieve së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhëni e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjesc të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë ne dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe përkompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit ne vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjate shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagesë për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhc Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtjer fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grüpuit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përpulhje me standarde, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe përmë tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritet nga një kontraktues i aftë dhe me përvjoe që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KV.K. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit te Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dënitimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianeve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianeve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Konratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit te tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuara.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsyet e mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose te eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërbimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar ne KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do te përmbate se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkon përdorëzim dhe miratim te vizatimeve, metodat e përgjithshme qe do ti zbatoje, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime ne programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervall jo më shumë se periudha e përcaktuara në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitura e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëloj ose të tris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndaloj qasjen në vend-punishtë për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishtë gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve te Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahan. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë te cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsyet mund të kerkohen nga Autoriteti Kontraktues

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet ne peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë te veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet ne shpenzime të Kontraktuesit, pa marre parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit te shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvèç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit te detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zgres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJSHTËRITË

Neni 20 Registri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përvèç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës qe detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bëre dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontroluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave qe duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon qe të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistër. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimive të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të janë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të janë objekt i një kërkese të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit te kontratës, numrin e Lotit dhe vandin ku do te zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuara në kërkësë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe përraportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet te dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues qe të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitet që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë në përbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, qe të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo

prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhc sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të jepë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritisë se mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrëthana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert qe zgjidhet me pëlgimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tillë ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikatë. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhct interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, c'rrcgulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përbajnjë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhct për sasinë c'punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktivitetave në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të

pranucshmec për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënë është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionalc nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garacion bankar "me kërkese".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft te deklaratës se llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- Shumen e cila sipas opinionit te tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- pas evidentimit te shumave te paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund te jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshoje te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqe për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet kommunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsyte të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi te jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa te jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkësës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontraten dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kérkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinvimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinvimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinvim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendor, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojsme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kuriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitive të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/ose
- ndërpërjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmceve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërpërje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsyen të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijojen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimesinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërpërje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksploidimet, tërmeti, zjarret, vërsimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërpërjen e kontratës.

Neni 39**Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektes do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40**Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nësc Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirim i ngjarjeve**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi;
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-25-3519-5-2-1/C1094

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>	<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1
	2.2
Siguria e ekzekutimit	10.1
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2
Programi	12.1
Fillimi i punëve	17.1
Dëmet e likuiduara	19.1

Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.

Kontraktuesi obligohet qe para nënshkrimit të kontratës të bëj depozitim e sigurisë së ekzekutimit **10%** i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej **120 ditë**.

Shuma minimale e sigurimit do të jetë:

- (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të janë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;
- (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjastueshme për zëvendësimin e tyre;
- (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.
- (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:
 - (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar

Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.

Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë

Data e fillimit do të jetë menjëherë pas pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit për fillim të punimeve

Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë.

Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë **0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës** për ditë.

Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është **10% e Çmimit final të Kontratës**.


Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Ekipi për menaxhimin e kontratës do të caktohet me vendim të ZKA.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë para fillimit të punimeve.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

SHPORTAT

Specifikimet teknike të detajuara:

- **Konstruksioni:** 1. Materiali i mbjatësit të shportës të jetë nga llamarina e çelikut (klasi I) me trashësi min 7mm. 2. Materiali shportës kryesore duhet të jetë nga llamarina e çelikut (klasi I) me trashësi min 5mm. 3. Shporta kryesore duhet të ketë edhe shportën e brendëshme e cila zhvendoset lehtas për të larguar mbeturinat, kjo shportë duhet të jetë nga llamarina e zinkuar me trashësi min 0.5mm dhe nuk ka nevojë të ngjyroset shporta gjithashtu duhet te permblaje edhe taketuken per cigare me mekanizmin e perzbrasje te cigarve me $t=5\text{mm}$.
- **Parandalimi i ndryshkjes, Mbrojtja e metaleve:** Shporta e xhepit të zinkohet dhe më pastaj të ngjyroset me ngjyrë elektrostatike pluhur dhe mepastaj te futet ne furr te ngjyrosjes ne temperatur 200°C , nuancën e ngjyrës e përkaton Autoriteti Kontraktues. Mbrojtja kunderkorrozion e metalit të bëhet sipas standartit: DIN-EN-ISO 12944 (standard për mbrojtje kunder korrezionit 6 shtresor. Të jetë rezistent ndaj gërvishjes, ndaj lagështisë, ndaj ndërrimit të temperaturave dhe poashtu të jetë rezistent ndaj nxehësisë deri në $+200^{\circ}\text{C}$. Shkalla e emetimit të substancave toksike të jetë në nivelin A+.
- **Transporti dhe Montimi:** Transporti dhe shpërndarja e shportave do të bëhet sipas kërkesës se AK. Duhet të bëhet gropimi dhe mbushja e bazamentit me beton me thellësi minimum 250mm me gjerësi dhe gjatësi min 350mmX350 me bulona të vendosur në këtë bazament në formë ankeri. Vendosja e shportave do të bëhet me bulona të vendosuar në secilin këndë. Kurse fiksimi do bëhet me nga dy dado në secilin bulon poashtu, ne secilin kende te vendosjes duhet te vendoset një distancer nga goma e forte me trashësi minimum 5mm.

Të punohet sipas detalit dhe dizajnit të prezantuar:




Specififikimet teknike të detajuarë:

FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MONTIMI I ULËSEVE PËR PARQE:

- **Konstruksioni:** të jetë nga çeliku me dimenione të prerjes têrthore min100 x min40 mm me trashësi të mureve min 2-5mm.(Klasi i parë)
 - **Parandalimi i ndryshkjes, Mbrotja e metaleve:** Të ngjyroset me ngjyre elektrostatike pluhur dhe mepastaj te behet pjekja e ngjyres ne temperatur 200 ° C kundër korrozion RAL 7016 Antracit mat. (3 në 1=bazë, shtresa e pare dhe shtresa finale) Mbrotja kunderkorrozion e metalit të bëhet sipas standardit: DIN-EN-ISO 12944 (standard për mbrotje kunder korrezionit 6 shtresor. Të jetë rezistent ndaj gërvishjes, ndaj lagështisë, ndaj ndërrimit të temperaturave dhe poashtu të jetë rezistent ndaj nxehësisë deri në + 200 ° C. Shkalla e emetimit të substancave toksike të jetë në nivelin A+.
 - Pjesa nga druri: Të jetë nga dru pishe rezistent ndaj lagështisë, çarjeve dhe plasaritjeve që shoqërohen me erozion. Dimensionet e prerjes têrthore janë: gjërsia=min50mm - max 60mm dhe trashësia =min 30mm - max 40mm
 - Lyreja e drurit: Vaj pa ngjyrë me baze uji për mbrotjen dhe shkelqimin e drurit. I dedikuar per dru në terene të jashtme. Vaji duhet të përbajë max. 5 g/l VOC (Volatile organic compounds)
 - Transporti dhe Montimi: Transporti dhe shpërndarja e ulëseve do të bëhet sipas kërkesës se AK. Duhet të bëhet gropimi dhe mbushja e bazamentit me beton me thellësi minimum 250mm me gjërsi dhe gjatësi min 200mmX600mm me bulona të vendosur në këtë bazament në formë ankeri. Vendosja e ulëseve do të bëhet me bulona të vendosuar në secilin këndë. Kurse fiksimi do bëhet me nga dy dado në secilin
- Të punohet sipas detalit dhe dizajnit të prezantuar.

Specififikimet e vizatimeve teknike






Specififikimet teknike të detajuara:



FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MONTIMI I SHPORTAVE TE MBETURINAVE PËR PARQE

- **Konstruksioni:** të jetë nga çeliku me dimenziione të prerjes tërthore min20 x min20 mm dhe Fi 20 me trashësi të mureve min 2mm.(Klasi i parë)
- **Parandalimi i ndryshkjes, Mbrotja e metaleve:** Të ngjyroset me ngjyre elektrostatike pluhur dhe mepastaj të behet pjekja e ngjyres ne temperatur 200 ° C kundër korrozion RAL 7016 Antracit mat. (3 në 1=bazë, shtresa e pare dhe shtresa finale) Mbrotja kunderkorrozion e metalit të bëhet sipas standardit: DIN-EN-ISO 12944 (standard për mbrotje kunder korrezionit 6 shtresor. Të jetë rezistent ndaj gërvishjes, ndaj lagështisë, ndaj ndërrimit të temperaturave dhe poashtu të jetë rezistent ndaj nxehësisë deri në + 200 ° C. Shkalla e emetimit të substancave toksike të jetë në nivelin A+.
- Shporta kryesore duhet të ketë edhe shportën e brendëshme e cila zhvendoset lehtas për të larguar mbeturinat, kjo shportë duhet të jetë nga llamarina e zinkuar me trashësi min 0.5mm dhe nuk ka nevojë të ngjyroset shporta gjitheashu duhet te permbojë edhe taketuken per cigare me mekanizimin e per zbrasje te cigarve me t=5mm.
- Pjesa nga druri: Të jetë nga dru pishe rezistent ndaj lagështisë, çarjeve dhe plasaritjeve që shoqërohen me erozion. Dimensionet e prerjes tërthore janë: gjërsia=min40mm - max 50mm dhe trashësia =min 20mm - max 40mm
 Gjatsi = min650mm - max 750mm
 - Lyreja e drurit: Vaj pa ngjyrë me baze uji për mbrotjen dhe shkelqimin e drurit. I dedikuar per dru në terene të jashtme. Vaji duhet të përbajë max. 5 g/l VOC (Volatile organic compounds)
 Të punohet sipas detalit dhe dizajnit të prezantuar.
- **Transporti dhe Montimi:** Transporti dhe shpërndarja e shportave do të bëhet sipas kërkesës se AK. Duhet të bëhet gropimi dhe mbushja e bazamentit me beton me thellësi minimum 250mm me gjëresi dhe gjatësi min 350mmX350 me bulona të vendosur në këtë bazament në formë ankeri. Vendosja e shportave do të bëhet me bulona të vendosuar në secilin këndë. Kurse fiksimi do bëhet me nga dy dado në secilin bulon poashtu, ne secilin kende te vendosjes duhet te vendoset një distancer nga goma e forte me trashësi minimum 5mm.



Ndërtimi i parkut dhe lodrave përfëmijë në rrugën "Gazmend Ymeri"					
$L=0+075 \text{ km}, B=5.00 \text{ m} \text{ dhe } b=2x0.5 \text{ m}$					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
I Punët Përgaditore					
1	Punët përgaditore përfillimin e punimeve, mobilizimi i makinerisë dhe vendosja e shenjave te nevojshme per siguri dhe paralajmerim të vendpunishtës.	komplet	1.00	200.00	200.00
2	Pastrimi i terrenit, kontrollimi i instalimeve nentokesore dhe largimi të gjitha pengesave të ndryshme në trasenë e rrugës. Materialt e largura transportohen në deponin e caktuar nga investitori në largësi max 15 km. Para fillimit të punimeve, investitorë duhet të siguroj të dhënat e instalimeve. Në rast të dëmtimit të instalimeve ekzistuese, duhet t'i rregulloj vetë punëkryesi.	m'	75.00	0.30	22.50
3	Shenjëzimi i trasës dhe përcjelja e punimeve me gjedjet	m'	75.00	1.00	75.00
Gjithsej totali me TVSH					297.50
II Punët e Dheut					
1	Gërmimi i dheut te kategoris III-IV ne trupin e rrugës dhe pjesët ku do t'ë bëhet sanimi i trupit rrugor në pjesët ku është e nevojshme, bartja e tij ne deponi të përshtatshme në largesë deri ne 15 km e caktuar nga investitori. Pjesa e materialit të gërmuar e cila është me permbytje gurore mund te perdoret përmbusje ne profillet ku mbushja është më e madhe se $t=1.0 \text{ m}$. Në këtë pozicion eshtë illogaritur edhe rregullimi i kyqjeve.	m³	135.00	2.50	337.50
2	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës përgaditjen e terenit tek pjesa ku do t'ë punohet pilatoja, stazat per ecje dhe uleset. Në çmim duhet t'ë përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km.	m²	600.00	0.50	300.00
3	Nivelizimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës. Moduli i shafitjes duhet t'ë jetë $Mv > 35 \text{ MPa}$.	m²	450.00	0.50	225.00
Gjithsej totali me TVSH					862.50
III Punët e Zhavorit					
1	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-63mm, $t=20 \text{ cm}$. Moduli i shafitjes duhet t'ë jetë $Mv > 70 \text{ Mpa}$.	m³	200.00	8.50	1,700.00
2	Furnizimi, shtrirja dhe ngjeshja e zhavorit 0-31mm $t=10 \text{ cm}$. Moduli i shafitjes duhet t'ë jetë $Mv > 90 \text{ Mpa}$. Në këtë pozicion eshtë illogaritur edhe sasia e materialit mbushës përmbytje te stacionazhat P15-P19 dhe rregullimin e kyqjeve anësore.	m³	40.00	9.50	380.00
3	Furnizimi, shtrirja dhe kompaktimi i zhavorit (materiali shterp nga gurthuesit) përfundimin e bankinave	m³	6.00	10.00	60.00
Gjithsej totali me TVSH					2,140.00
IV Punet e gjelbrimit dhe Lodrat e Femijëve					

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. SH.H. — 
 2. A.U. — 

1	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e dheut natyral-teksitura e dheut duhet të jetë lymore, lymore-argjillore ose ranore-argjillore, pra nuk duhet të jetë shumë e rëndë (argjillore) ose ranore. Nuk duhet të përbaj gurë dhe mbetje tjera të padëshiruara. Pastaj duhet të jetë e pasur me materie ushqyese dhe të ketë pH optimale, përkatësisht mund të jetë e dobët acidike deri e dobët bazike. Mbushja duhet të behet per te niveizuar terenin brënda hapesires se parkut me trashesi ~30cm. Për këtë duhet pasur kujdes vendi se ku merret dhei, al duhet të merret në shtresën e sipërme të tokës përkatësisht në thellësi 20-25 cm, e kurresi nuk duhet marr dhe në thellësi më të mëdha se 50 cm për shkak se kalon në substratin amë të tokës dhe nuk ka veti të mira fizike, kimike e biologjike. Te gjitha punet duhet të kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhëzim të organit mbikqyres.	m ³	890.00	4.00	3,560.00
---	---	----------------	--------	------	----------

1. SH.H. - 
 2. A. D. - 
 3. D. L. - 


	Furnizimi dhe mbjellja e Drunjeve Dekorativ, KUMBULLA JAPONEZA , Diametri i trungut të pishave të jetë 8-10 cm. Në qmimilogaritet mirëmbajtja e gjelbrimit me ujje, ose rikultivimin e sërlishem nëse mbjelljet dështojnë. Lartësia e DRUNJEVE të jetë 1.5m-1.6m dhe të mbjellen në distancë nga njëra tjera sic eshte parapare . Kumbullat Japoneza parashihet te jene te formesaura , forma e te cilave duhet te perzgjidhet nga menaxheri i kontrates. Ne qmim te perfshihet edhe hapja e gropes per mbjelljen e tyre. Verejtje: Drunjet Dekorativ të kenë CERTIFIKATË FITOSANITARE të AVUK-Republikës së Kosovës. Drunjet Dekorativ të janë të shendosh nga sëmundjet dhe në gjendje të mirë.		copë	40.00	30.00	1,200.00
2	Furnizimi dhe mbjellja e barit holandez ne terë sipërfaqen e parkut, te behet rrafshimi, frezimi dhe pastrami i Terenit nga mbetjet, largimi i mbeturinave te ngurta, mbjellja e barit dhe njësia me cylinder. Verejtje: Tek pjesë e drunjeve dekorativ brenda hapësires siq edhe janë parapare ne projekt duhet te behet trajtimi i terenit dhe mbjellja e barit sikur ne vlatime.	m2	900.00	2.00	1,800.00	
3	FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MONTIMI I ULËSEVE PËR PARQE SIPAS SPECIFIKIMIT TEKNIK: Cod B102	cope	16.00	320.00	5,120.00	
4		cope	8.00	320.00	2,560.00	
5	FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MONTIMI I SHPORTAVE TË XHEPIT SIPAS SPECIFIKIMIT TEKNIK Code B 106	cope	8.00	320.00	2,560.00	
5	FURNIZIMI, TRANSPORTI DHE MONTIMI I SHPORTAVE TË XHEPIT SIPAS SPECIFIKIMIT TEKNIK Code B 103	cope	8.00	320.00	2,560.00	

1. SH. H. - 

2. A. U. - 


3. D.I. - 

6	Furnizimi me material si dhe montimi i luhatëseve përfshirë të vegjelë 3-12 vjet (Steel swings) me 2 luhatse, luhatset metalik dhe me drrasa te klasses 1 te ngjyrosura te ladhura me zingjir ne llagerin e salduar ne gyp metalik 76 mm . Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themelive nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiko foton " Hulaja per dy fëmijë ".		copë	1.00	550.00	550.00
7	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave përfshirë të vegjelë (3-8) vjet, lodrat me suste per levizje (Springers) . Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themelive nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiko foton " Moduli spiral ne formë qeni "		copë	2.00	350.00	700.00
8	Furnizimi me material si dhe montimi i lodrave përfshirë të vegjelë (3-8) vjet, lodrat me suste per levizje (Springers) . Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional përfshirë punimin e themelive nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet. Shiko foton " Moduli spiral ne formë delfini " Nr.37		copë	2.00	350.00	700.00
9	Furnizimi dhe montimi i lodrave "Balancing-146 kg", përfshirë 6-12 vjet, lartësia e lirë e rënjes 200cm. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional duke përfshirë: bazamentin-themelin nga BA dhe ankerimin me ankera special - të gjitha këto në tëresi sipas udhëzimit dhe standardeve të prodhuesit. Lodra duhet të korrespondoj me foton dhe me dimensionet e struktures 311cm x 117cm.		copë	1.00	650.00	650.00

1. SH.H. - 
 2. A.U. - 

Furnizimi dhe montimi i paisjes për lodra me shtyje në drejtim poshtë lartë, katër ulse druri i kualitetit të lartë të vendosurë në një tra nga materiali i çelkut tub i glavanzuar ø90x3mm, më gjatësi 430cm.. Trau horizontal duhet të mbeshitet me llagera në dy shtylla metallike. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jetë funksional perfshirë vendosjen e dy sustat nga goma dhe punimin e themelive nga betoni i armuar si dhe të gjitha ankerimet - ne teresi sipas udhezimit te prodhuesit. Modeli të Jete si në foto, si dhe ngjyra të përcaktohet nga autoriteti kontraktues.		copë	2.00	550.00	1,100.00
Gjithsej totali me TVSH					20,500.00

1. SH.H. - 


2. A.U. - 

3. D.L. - 

V	Trupat ndriques				
1	Furnizimi ,montimi me trup ndriques se bashku me shtylen e ndriqimit per pärqe ne lartesi 3 m shih foton	copë	14.00	350.00	4,900.00
2	Furnizimi dhe montimi i kabilove energjetike ne topsor TIP - PPOONYY - 4x16mm ² .	m	170.00	5.00	850.00
Gjithsej totali me TVSH				5,750.00	
VI	Punët e Betonit				
1	Gurët skajorë dhe kubëzat				
1	Furnizimi ,shtrirja dhe ngjeshja e rëres 10-20mm, d=5cm (në gjendje të ngjeshur)	m ³	29.60	12.00	355.20
2	Furnizimi dhe montimi i Gurëve skajorë nga betoni 18/24 cm, t8 klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaq qimentoje si dhe perpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm ($\pm 2\text{mm}$))	m ³	160.00	14.00	2,240.00
3	Furnizimi dhe montimi i Gurëve Skajor nga betoni 10/20 cm, t8 klasës C-30/37 (duke llogaritur edhe betonin dhe mbushjen e fugave me llaq qimentoje si dhe përpunimin e tyre. Gjerësia e fugave të jetë 12mm ($\pm 2\text{mm}$))	m ³	240.00	10.00	2,400.00
4	Furnizimi dhe montimi i kubëzave nga betoni me trashësi t=8cm përtrotuar. Kubëzat duhet të janë t8 klasës C-30/37. Ngjyra dhe modelli të zgjedhen nga Investitorë.	m ²	750.00	18.00	13,500.00
5	Furnizimi dhe betonimi i te gjitha bazamenteve te lodrave , bazamentit te karrigeve, shportave ,te shtyllave te ndriqimit si dhe betonimi i skajoreve	m ³	20.00	88.30	1,766.00
Gjithsej totali me TVSH				20,261.20	

REKAPITULLIMI		
I	Punët Pregaditore	297.50
II	Punët e Dheut	862.50
III	Punët e Zhavorit	2,140.00
IV	Punet e gjelbrimit dhe Lodrat e Femijëve	20,500.00
V	Trupat ndriques	5,750.00
VI	Punët e Betonit	20,261.20 €
Gjithsej totali me TVSH		49,811.20 €

1. SH. H. -

2. A. U. - 

3. D. L. - 

**Sigurimi për Garanci**
Guarantee Insurance

Seria |

10001228352

Për

KOMUNA E GJAKOVËS

(ernri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

Ndërtimi i parkut dha lodrave për fëmijë në rrugën Gazmend Ymeri

Titull
TitleEmri i Ofertuesit
Name of the Bidder

"BEREQETI ING" SH.P.K

Prej
From

03.07.2025

Adresa
Address

Korrotcë e Epërme, Parku i Biznesit, P.n.

Deli
To

02.11.2025

Telefon
Telephone

049-386-007

Shuma e sigurimit
Insured sum

4,981.12 €

Numri i personal / biznesit
Personal / business number

810845638

Primi
Premium

89.66 €

Data e lëshimit
Date of issue

03.07.2025

TVSH
VAT

16.14 €

Numri i prokurimit
Procurement number

632-25-3519-5-2-1

Totali për pagesë
Total for payment

105.80 €

Lloji i kontratës
Contract type

Garanci Kontrate

AUTORITETI KONTRAKTUES

Numri personal / biznesit
Personal / business number

00000000

Vendi
City

Gjakovë

Adresa
Address

Rr "Nënë Tereza"

Telefon
Telephone

38-200-44041

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se pothimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta
dhe nëqoftëse ka fshehje apo shtrembërim të faktave, unë heq do të nga dëmshpërbimbi
në rast dëmi. Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondave është në përpunë me
Ligjin nr.05/L-096 si dhe Nenin 9 të Rregullores për parandalimin e pastrimit të parave
dhe financimit të terroristëve nga Banka Qendrore të Kosovës

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and it
there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage.
The police officer declares that the origin of the funds is in accordance with Law no. 05/
L-096 as well as Article 9 of the Regulation on the prevention of money laundering and
terrorist financing of the Central Bank of Kosovo

Agjenti

Prisig Online



Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: Info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjja Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Seria |

10001228352

Për

KOMUNA E GJAKOVËS

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

"BEREQETI ING" SH.P.K

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka manë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Ndërtimi i parkut dhe lodrave për fëmijë në rrugën Gazmend Ymeri

të dhënë me numrin e Prokurimit

632-25-3519-5-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci;

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

4,981.12 €

Katër Milje e Nëntë Qind e Tetëdhjetë e Një Euro e Dymbëdhjetë Cent

(shuma e garancisë në numra dhë në fjalë)

dhe ne manim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkatim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, që kjo shkakton dëm të konsiderueshëm te Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të korriguese të përmirësimi e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, që kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realzohet dhe pa asnjë ankec ose argument, të gjitha shumat brenda llimiteve të

4,981.12 €

(shuma e garancisë)

sic është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyot ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuarkëtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

03.07.2025

deri më

02.11.2025

Lëshuar në

Prishtinë

datë

03.07.2025

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRIŠTINË



Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjja Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	BEREQETI ING SH. P. K
Adresa	PARKU I BIZNESIT DRENAS
Qyteti	DRENAS
Kodi Postar	
Kontakti	049/386-007
Telefoni	
Fax	
E-mail	bereqeti-ing@hotmail.com
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	BEREQETI ING SHPK
Adresa	PARKU I BIZNESIT PN GLLOGOC
Qyteti	DRENAS
Kodi Postar	
Shteti	KOSOVE
Llogaria Bankare	1701001012678468
IBAN (opcionale)	XK051701001012678468
BIC (Opcionale)	NLPRXKPR

SHËNIME:

